

V E N D I M
Nr. 274, datë 10.6.1999

PËR KONVERTIMIN NË AR TË REZERVAVE NË ARGJEND TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 «Për bankën e Shqipërisë», me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. E gjithë sasia e argjendit, që i përket rezervave të metaleve të çmuara të Këshillit të Ministrave dhe që ruhet në Thesarin e Bankës së Shqipërisë, të konvertohet në ar.
 2. Shpenzimet e nevojshme që herë pas here do të kërkohen për rafinerimin e sasisë së argjendit, sipas standarteve ndërkombëtare, të përballohet nga vlera, sipas pikës 1. Konvertimi në ar do të bëhet në përputhje me çmimin përkatës dhe sipas kursit zyrtar të tregut të metaleve të çmuara.
 3. Sasia e arit, e rezultuar nga konvertimi i argjendit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, pasi të zbriten shpenzimet, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të depozitohet për çdo transaksion në një llogari të veçantë, «Depozita ari» në emër të Këshillit të Ministrave.
 4. Prekja e gjendjes së llogarisë, sipas pikës 3, ose konvertimi i saj në valutë ose në lekë, do të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
 5. Banka e Shqipërisë, për çdo transaksion që do të kryejë sipas pikave të këtij vendimi, duhet të marrë paraprakisht miratimin nga Ministria e Financave (Drejtoria e Thesarit)
 6. Ngarkohen Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko